D E K R E T
Nr.938, datë 11.10.1994

PËR DETYRIMIN SHKOLLOR

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Kur nxënësit e moshës 6-16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë si më poshtë:

1.1. Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30-50 për qind të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është nga 10 000 deri në 30 000 lekë dhe, në rast përsëritje gjatë po atij viti, gjoba është 50 000 lekë.

1.2. Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye mbi 50 për qind të kohës në dy muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është nga 50 000 deri në 70 000 lekë dhe, në rast përsëritje gjatë po atij viti ose braktisje të shkollës, gjoba është 100 000 lekë.

1.3. Vendimi i dënimit me gjobë jepet nga drejtori i drejtorisë arsimore në rreth në bazë të propozimit të drejtorit të shkollës.

Kur vërehen raste të shkeljes së këtij dekreti nga drejtori i shkollës ose drejtori i drejtorisë arsimore në rreth, ata dënohen me gjobë në masën 30 000 lekë dhe, në rast përsëritje, ndaj tyre merret masa e largimit nga puna.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 2

Ndalohet punësimi i fëmijëve që përfshihen në detyrimin shkollor. Kur vërtetohen raste të punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, punëdhënësi shtetëror a privat dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektori i punës me gjobë 100 000 lekë dhe, në rast përsëritje, me gjobë 200 000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Neni 3

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i vendimeve të dënimit me gjobë bëhet sipas rregullave të caktuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 4

Ligji nr.7635, datë 11.11.1992 "Për disa ndryshime në ligjin nr.4624, datë 24.12.1969 "Për sistemin e ri arsimor", shfuqizohet.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KUNDERFIRMOHET

KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha